

DEKLARATË

Tiranë, më 19 nëntor 2001

Më 17 nëntor 2001 u zhvilluan në Kosovën e lirë zgjedhjet e para të përgjithshme pluraliste, të lira e të ndershme, për Parlamentin e Kosovës, i cili do të konstitujë Qeverinë, Presidentin dhe të gjitha institucionet, konform kornizës aktuale kushtetuese.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

Përsëendet, në këtë moment historik, popullin e Kosovës dhe minoritetet për pjesëmarrjen e tyre në këtë proces të rëndësishëm, për vetëdijen e lartë qytetare e përgjegjësitë e zhvilluara politike, për kulturën demokratike dhe tolerancën e shprehur, duke krijuar një imazh pozitiv e optimist për qytetarët e Kosovës dhe të gjithë komunitetin ndërkombëtar.

vlerëson rolin e të gjithë spektrit politik kosovar, të institucioneve ndërkombëtare, si UMNİK, OSBE, KFOR, për përgatitjen dhe menaxhimin e suksesshëm të këtyre zgjedhjeve;

konsideron se këto zgjedhje, të lira e demokratike, janë një ngjarje e rëndësishme, madhore për ndërtimin e institucioneve demokratike vetëqeverisëse në Kosovë, për ngritjen e shtetit të së drejtës, nëpërmjet të cilit të gjithë qytetarët e Kosovës të ndihen të barabartë përpara ligjit, ku popullsia shqiptare dhe minoritetet të bashkëjetojnë e bashkëpunojnë për të ndërtuar të ardhmen e tyre europiane në një shoqëri multietnike, konform standardeve ndërkombëtare;

çmon se këto zgjedhje do t'i shërbejnë jo vetëm stabilitetit e bashkëjetesës në Kosovë, por ato janë edhe një hap i rëndësishëm i rritjes së faktorit politik shqiptar drejt forcimit të sigurisë rajonale e përsheptimit të të gjitha proceseve integruese në rajon e më gjerë;

shprehet për një bashkëpunim aktiv në Parlamentin e Kosovës, me synim nxitjen e marrëdhënieve në të gjitha fushat dhe drejtimet prioritare me interes reciprok, në funksion të rritjes së stabilitetit, sigurisë dhe integritetit në rajon dhe në Europë.